REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA LUSHNJE
DREJTORIA E PERGJITHSHME E SHERBIMIT PUBLIK E SOCIAL

NR 536 PROT

Lushnje me 14/01/2026

RELACION

MBI KRITERET QË DO TË NDIQEN PËR FAMILJET NË NEVOJË QË DO TË TRAJTOHEN MË NDIHMË EKONOMIKE DERI NË 6% TË FONDIT TË KUSHTËZUAR PËR BLLOK – NDIHMËN EKONOMIKE SI DHE PËR ATO QË DO TË TRAJTOHEN ME FONDET E BUXHETIT VENDOR PËR VITIN 2026

Në fillim të cdo viti kalendarik bëhet miratimi i kritereve që do të ndiqen për familjet , në nevojë, që do të trajtohen nga programi i bllok –ndihmës 6% nga fondi kushtëzuar, nga fondet e buxhetit vendor. Për kete Drejtoria e Shërbimit Social në mbështetje të ligjit Nr.139 datë 17.12.2015 për veteqeverisjen vendore, ligji.9936 datë 26.06.2008 'Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë" i ndryshuar, Ligji nr. 109/2017 datë 30.11.2017 " PËR BUXHETIN E SHTETIT" për vitin 2026. Ligji nr.9355 date 10.03.2005" Per ndihmën dhe përkujdesin shoqëror" i ndryshuar, V.K.M nr. 955 datë 07.12.2016 të Këshillit të Ministrave "Për përcaktimin e kritereve të procedurave si dhe dokumentacionit dhe masës së përfitimit të ndihmës ekonomike si dhe udhezimeve nr .3,4,5 datë 17.02.2017 "Mbi përdorimin e fondit të kushtëzuar për bllok ndihmën ekonomike deri në 6%", të Ministrisë së Mirëqenies Sociale, Këshilli Bashkiak Vendosi miratimin e kritereve për familjet në nevojë që do të trajtohen me ndihmë ekonomike deri në 6% të fondit të kushtëzuar për bllok – ndihmën ekonomike si dhe për ato që do të trajtohen me fondet e buxhetit vendor.

Miratohen që prej fillimit të vitit nga Këshilli Bashkiak

I. Kriteret për përfitues nga programi i bllok –ndihmës 6 % nga fondi kushtëzuar.
II. Kriteret për trajtimin me fondet e buxhetit vendor:

-Masa e ndihmës ekonomike për cdo familje përllogaritet sipas, ***Udhëzimit nr. 4, datë 17.02.2017' Për llogaritjen e përfitimit të ndihmës ekonomike*** ".
-Familjet e përzgjedhura përfitojnë ndihmën ekonomike nga programi i bllok-ndihmës 6% të fondit të kushtëzuar dhe nga fondi i buxhetit vendor.

Drejtori Shërbimit Social
Anila Çela

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA LUSHNJE
DREJTORIA E PERGJITHSHME E SHERBIMIT PUBLIK E SOCIAL

Nr.536/1 prot.

Lushnje, më 14.01.2026

PROJEKT VENDIM

NR 01 DATË 14/01 2026

MBI

MIRATIMIN E KRITEREVE PËR FAMILJET NË NEVOJË QË DO TË TRAJTOHEN ME NDIHMË EKONOMIKE DERI NË 6% TË FONDIT TË KUSHTËZUAR PËR BLLOK – NDIHMËN EKONOMIKE SI DHE PËR ATO QË DO TË TRAJTOHEN ME FONDET E BUXHETIT VENDOR PËR VITIN 2026.

Këshilli Bashkiak në mbledhjen e datës __/___/2026 pasi analizoi relacionin e paraqitur nga Drejtoria e Shërbimit Social si dhe në mbeshtetje të ligjit Nr.139 datë 17.12.2015 "Për vetëqeverisjen vendore", ligji.9936 datë 26.06.2008 'Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë" i ndryshuar, Ligji nr. 109/2017 datë 30.11.2017 " PËR BUXHETIN E SHTETIT" për vitin 2026. Ligji nr 9355 datë 10.03.2005" ëer ndihmën dhe përkujdesin shoqëror" i ndryshuar, V.K.M nr. 955 datë 07.12.2016 të Këshillit të Ministrave " Për përcaktimin e kritereve të procedurave si dhe dokumentacionit dhe masës së përfitimit të ndihmës ekonomike si dhe udhëzimeve nr.3,4,5 datë 17.02.2017 "Mbi përdorimin e fondit të kushtëzuar për bllok ndihmën ekonomike deri në 6%", të Ministrisë së Mirëqënies Sociale, Këshillit Bashkiak :

I Propozojmë:

Miratimin e kritereve për familjet në nevojë që do të trajtohen me ndihmë ekonomike deri në 6% të fondit të kushtëzuar për bllok – ndihmën ekonomike si dhe për ato që do të trajtohen me fondet e buxhetit vendor, si me poshtë vijon :

I. Kriteret për përfitues nga programi i bllok –ndihmës 6 % nga fondi kushtëzuar.

1.Familjet në nevojë perzgjidhen nga lista e familjeve që kanë aplikuar brenda tre muajve të fundit, nëpërmjet regjistrit elektronik dhe që nuk janë shpallur fitues nga sistemi i pikëzimit.
2. Familja përpara se të përzgjidhet për tu trajtuar me këtë fond duhet të jetë verifikuar paraprakisht nga administratori shoqëror.
3. Familja duhet të jetë familje në nevojë, të jetë pa të ardhura ose me të ardhura të pamjaftueshme.

4. Rastet kur k/familjari ose dhe anetar të tjerë madhore , të cilët janë të paaftë për të punuar, por për shkak të legjislacionit nuk përfitojnë pagesa PAK.

II. Kriteret për trajtimin me fondet e buxhetit vendor:

1 .Familjet të cilat kanë aplikuar për ndihmë ekonomike dhe nuk janë përzgjedhur si fitues nga sistemi.
2. Familja duhet te jete familje ne nevoje, te jete pa te ardhura ose me te ardhura te pamjaftueshme.
3. Rastet kur k/familjari ose dhe anetar të tjerë madhore , të cilët janë të paaftë për të punuar, po për shkak të legjislacionit nuk përfitojnë pagesa PAK.
4. Familjet me k/familjare gra (të veja, të divorcuara, vajza nëna) me të paktën një fëmije që ndjekin arsimin bazë ose të lartë.
5. Familje që kanë fëmijë në moshë madhore por që kanë probleme sociale (përdorues të lëndëve narkotike, probleme me ligjin etj) të cilët kanë vështirësi punësimi.
6. Familjet rome të cilat kanë probleme me rregjistrimin dhe transferimin.
7. Familjet me një anëtar që nuk kanë të ardhura apo i kanë të ardhurat e pamjaftueshme.
8. Prindër me shumë fëmijë.

-Masa e ndihmës ekonomike për cdo familje do të përllogaritet sipas, ***Udhëzimit nr. 4, datë 17.02.2017' Për llogaritjen e përfitimit të ndihmës ekonomike*** ".
-Familjet e përzgjedhura do të përfitojnë ndihmën ekonomike nga programi i bllok-ndihmës 6% nga fondi i kushtëzuar dhe nga fondi i buxhetit vendor.

Drejtori Shërbimit Social
Anila Çela

Drejtori Juridik
Bedri Hida

Kryetari i Bashkisë
Eriselda Sefa